

V E N D I M

Nr. 485, datë 21.09.2023

“PËR

MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR ZGJEDHJEN E KRYETARIT TË GJYKATËS SË LARTË”

Mbështetur në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, nenin 51 pika 9 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (të ndryshuar) si dhe në nenin 26, pika 1 të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” (të ndryshuar), Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI :

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

1. Ky vendim përcakton rregulla të hollësishme për procedurat e mbledhjes së përgjithshme, votimin si dhe mënyrën e numërimit të rezultatit të votimit për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë.

Neni 2

Mbledhja e Përgjithshme

Për efekt të këtij vendimi, mbledhja e përgjithshme është mbledhja e të gjithë anëtarëve të emëruar gjyqtarë në Gjykatën e Lartë sipas neneve 48 dhe 49 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 3

Zgjedhja e Kryetarit të Gjykatës së Lartë

1. Kryetari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë nëpërmjet procesit të votimit, për një periudhë 3 (tre) vjeçare pa të drejtë rizgjedhjeje.

2. Kryetar i Gjykatës së Lartë zgjidhet gjyqtari i cili ka të paktën 3 (tre) vite përvojë profesionale si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nuk ka asnjë masë disiplinore në fuqi si edhe është vlerësuar të paktën “shumë mirë” në dy vlerësimet e fundit etike dhe profesionale. Gjyqtarët e emëruar nga radhët e kandidatëve jogjyqtarë në Gjykatën e Lartë, duhet të jenë vlerësuar të paktën “shumë mirë” në vlerësimin e mëparshëm etik dhe profesional.

KREU II

THIRRJA E MBLEDHJES SË PËRGJITHSHME DHE PROCEDURA PËR FUNKSIONIMIN E SAJ

Neni 4

Drejtimi i Mbledhjes së Përgjithshme

1. Mbledhja e përgjithshme thirret dhe kryesohet nga Kryetari i Gjykatës së Lartë. Në mungesë të Kryetarit të Gjykatës së Lartë për shkak të mbarimit të parakohshëm të mandatit të tij, mbledhja e përgjithshme thirret dhe kryesohet nga Zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë.
2. Nëse Kryetari apo Zëvendëskryetari nuk është i mundur objektivisht të thërrasë dhe drejtojë mbledhjen, ajo thirret dhe drejtohet nga gjyqtari me përvojën profesionale më të gjatë si gjyqtar në Gjykatën e Lartë.
3. Në mbledhjen e përgjithshme për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë merr pjesë si vëzhgues edhe një anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Neni 5

Ftesa dhe Afatet e Paraqitjes së Kandidaturave

1. Kryetari i mbledhjes së përgjithshme, që sipas rrethanave të përmendura në nenin 4 të këtij akti, mund të jetë Kryetari i Gjykatës së Lartë, Zëvendëskryetari i saj ose gjyqtari me përvojën profesionale më të gjatë si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, fton të gjithë kandidatët që përmbushin kriteret ligjore për të kandiduar brenda një afati 10-ditor i cili fillon:
 - a) Të paktën gjashtëdhjetë (60) ditë para datës së mbarimit të mandatit të kryetarit në detyrë.
 - b) Të paktën dhjetë (10) ditë pas mbarimit të parakohshëm të mandatit të kryetarit.
2. Në qoftë se në përfundim të afateve të sipërcituara nuk është thirrur mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve për zgjedhjen e kryetarit, ajo mund të thirret nga 1/10 e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë ose nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.
3. Kandidatët brenda afatit ligjor, paraqesin kërkesën me shkrim dhe platformën personale.
4. Aktet sipas pikës 2 të këtij neni protokollohen në regjistrin e posaçëm që mbahet për këtë qëllim, i cili në përfundim të procesit, arkivohet së bashku me të gjitha aktet e kësaj procedure.

Neni 6

Caktimi i Ditës së Zhvillimit të Mbledhjes së Përgjithshme

Jo më vonë se 3 (tre) ditë nga mbyllja e procedurës për paraqitjen nga kandidatët të shprehjes së interesit për t'u zgjedhur kryetar i Gjykatës së Lartë, kryetari i mbledhjes së përgjithshme (Kryetari ose Zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë), ose subjektet e tjera të parashikuara në

nenin 5 të këtyre rregullave, caktojnë datën, ditën dhe orën e zhvillimit të mbledhjes së përgjithshme.

Neni 7

Thirrja e Mbledhjes së Përgjithshme

1. Kryetari i Gjykatës së Lartë njofton thirrjen e mbledhjes së përgjithshme, si dhe shpërndan listën e kandidatëve që kanë shprehur interesin për kryetar, anëtarëve të mbledhjes së përgjithshme të Gjykatës së Lartë të paktën 1 (një) muaj para mbarimit të mandatit. Mbledhja e përgjithshme zhvillohet të paktën 2 (dy) javë para mbarimit të mandatit të kryetarit.

2. Zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë njofton thirrjen e mbledhjes së përgjithshme, si dhe shpërndan listën e kandidatëve që kanë shprehur interesin për kryetar, anëtarëve të mbledhjes së përgjithshme të Gjykatës së Lartë të paktën 2 (dy) javë pas kalimit të afatit të mbarimit të parakohshëm të mandatit të kryetarit. Mbledhja e përgjithshme zhvillohet të paktën 1 (një) muaj pas mbarimit të parakohshëm të mandatit të kryetarit.

Neni 8

Përgatitja e Mbledhjes së Përgjithshme

1. Kancelari i Gjykatës së Lartë ndihmon kryetarin e mbledhjes së përgjithshme në përgatitjen dhe mbarëvajtjen e zhvillimit të mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve dhe është veçanërisht përgjegjës për:

- a) Njoftimin e gjyqtarëve për datën, ditën dhe orën e mbledhjes;
- b) Mbledhjen e kërkesave për shprehjen e interesit nga gjyqtarët që duan të kandidojnë sipas modelit në aneksin nr. 1 bashkëlidhur këtyre rregullave;
- c) Përgatitjen e fletës së votimit sipas modelit në aneksin nr. 2 dhe nr. 3 bashkëlidhur këtyre rregullave;
- ç) Ngritjen e komisionit të votimit të përbërë nga Kancelari, Kryesekretari dhe një sekretar gjyqësor;
- d) Numërimin e votave dhe shpalljen e rezultatit;
- dh) Marrjen e masave për regjistrimin audio të mbledhjes, nëse është i mundur realizimi i regjistrimit;

2. Në mungesë të Kancelarit këto përgjegjësi i ushtron Kryesekretari i Gjykatës së Lartë dhe në mungesë të tij nga sekretari me përvojën profesionale me të gjatë në këtë gjykatë.

Neni 9

Lista e Kandidatëve

1. Para zhvillimit të mbledhjes, kryetari i mbledhjes së përgjithshme përgatit listën e kandidatëve që kanë shprehur interes. Për këtë qëllim, kryetari i mbledhjes së përgjithshme kërkon informacion nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.
2. Lista e kandidatëve që kanë shprehur interes për kryetar të Gjykatës së Lartë si edhe informacioni për secilin kandidat të sjellë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor publikohet në faqen e internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Gjykatës së Lartë.

Neni 10

Pjesëmarrja në Mbledhjen e Përgjithshme

1. Në mbledhjen e përgjithshme marrin pjesë të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Lartë. Mbledhja është e vlefshme kur në të marrim pjesë jo më pak se $2/3$ e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë. Gjyqtarët e pranishëm në mbledhje kanë për detyrë të votojnë. Gjyqtari merr pjesë personalisht në mbledhjen e përgjithshme.
2. Në rast se në mbledhjen e përgjithshme janë të pranishëm më pak se numri i parashikuar në pikën 2 të këtij neni, kryetari i mbledhjes shtyn mbledhjen dhe cakton një datë tjetër për zhvillimin e saj.

Neni 11

Zhvillimi i Mbledhjes së Përgjithshme

1. Kryetari i mbledhjes merr masa për zhvillimin normal të mbledhjes së përgjithshme dhe e drejton atë deri në daljen e rezultatit përfundimtar.
2. Procedura e zhvillimit të mbledhjes së përgjithshme pasqyrohet në një procesverbal, i cili nënshkruhet nga kryetari i mbledhjes dhe sekretarja e ngarkuar për mbajtjen e tij.

KREU III

ZGJEDHJA E ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË VOTIMIT

Neni 12

Komisioni i Votimit

1. Për zhvillimin e procesit të votimit dhe shpalljen e rezultatit për zgjedhjen e kryetarit të Gjykatës së Lartë nga mbledhja e përgjithshme, krijohet komisioni i votimit.
2. Në fillim të mbledhjes së përgjithshme, kryetari i saj lexon emrat e kandidatëve që kanë shprehur interesin për pozicionin e kryetari të Gjykatës së Lartë dhe secili prej tyre prezanton platformën përkatëse. Kryetari ngre komisionin e votimit në të cilin marrin pjesë Kancelari, Kryesekretari dhe sekretari me përvojën profesionale me të gjatë në Gjykatën e Lartë. Në mungesë të Kancelarit ose të Kryesekretarit, vendin e tyre në komisionin e votimit e merr sekretari i radhës me përvojën më të gjatë profesionale në këtë gjykatë. Në rast pamundësie, kryetari i mbledhjes së përgjithshme mund të ngrejë komisionin e votimit me një tjetër përbërje

me pjesëmarrjen e punonjësve të tjerë të gjykatës. Kancelari dhe në mungesë të tij, Kryesekretari drejton komisionin e votimit.

Neni 13

Detyrat e Komisionit të Votimit

1. Komisioni i votimit është përgjegjës për zhvillimin e procedurës së votimit, numërimin e votave dhe shpalljen e rezultatit përfundimtar të votimit.
2. Përpara fillimit të votimit, komisioni i votimit përgatit fletën e votimit sipas formatit bashkëlidhur këtyre rregullave.
3. Para fillimit të votimit, komisioni i votimit shpjegon mënyrën dhe rregullat e votimit dhe më pas shpërndan fletën e votimit, pasi e ka nënshkruar atë.
4. Numri i fletëve të votimit të përgatitura nga komisioni i votimit është i barabartë me numrin e gjyqtarëve të pranishëm në mbledhjen e përgjithshme. Në rast dëmtimi të fletës së votimit, komisioni përgatit një fletë të re votimi dhe vendos fletën e dëmtuar në një zarf të posaçëm.
5. Komisioni i votimit në ushtrimin e funksioneve të mësipërme drejtohet nga Kancelari.

Neni 14

Përmbajtja e Fletës së Votimit

1. Votimi bëhet duke përdorur fletën e votimit, të miratuar sipas modelit të aneksit nr. 2 dhe nr. 3 bashkëlidhur këtyre rregullave.
2. Kandidatët renditen në fletën e votimit sipas rendit alfabetik.
3. Fleta e votimit përmban elementët e mëposhtëm:
 - a) Emri dhe mbiemri i plotë i kandidatit/kandidatëve;
 - b) Vendin e posaçëm për votim;
 - c) Një shënim në fund të fletës së votimit ku renditen shkaqet ligjore të pavlefshmërisë së votës.

Neni 15

Procesi i Votimit

1. Votimi për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë është i fshehtë dhe individual.
2. Procesi i votimit është i hapur për publikun dhe rezultati i votimit bëhet publik menjëherë.
3. Pas shpjegimit të rregullave të votimit, komisioni vijon me procedurën e votimit për kryetarin e gjykatës.
4. Anëtarët e komisionit të votimit nënshkruajnë dhe vulosin të gjitha fletët e votimit, të cilat janë të barabarta me numrin e gjyqtarëve të pranishëm në mbledhjen e përgjithshme.

5. Komisioni i votimit i dorëzon çdo gjyqtari fletën përkatëse të votimit. Gjyqtari plotëson fletën e votimit në dhomën e fshehtë, e më pas e hedh në kutinë e votimit.
6. Çdo gjyqtar ka të drejtën e një vote. Abstenimi nuk lejohet.
7. Gjyqtarët ndjekin rregullat e votimit si vijon:
 - a) votohet vetëm në fletën e votimit të vënë në dispozicion nga komisioni i votimit;
 - b) votohet duke vendosur në kutinë përkatëse, përbri emrit të kandidatit të preferuar, njëri nga shenjat “+” ose “x” ose “v”.
8. Në fletën e votimit nuk duhet të bëhen shënime të tjera, përveç shenjës së votimit.

Neni 16

Pavlefshmëria e Votës

1. Vota është e pavlefshme kur:
 - a) fleta e votimit nuk ka të njëjtët elementë, sipas modelit të miratuar;
 - b) në fletën e votimit janë bërë shënime në favor ose në disfavor të kandidatit/kandidatëve;
 - c) është votuar për më shumë se një nga kandidatët;
 - ç) nuk është votuar për asnjë nga kandidatët;
 - d) nuk është e qartë se për cilin kandidat është votuar;
 - dh) është votuar për një person që nuk është regjistruar si kandidat në fletën e votimit.

Neni 17

Numërimi i Votave

1. Pas përfundimit të votimit, komisioni i votimit hap kutinë në praninë e të gjithë gjyqtarëve të mbledhjes së përgjithshme. Komisioni i votimit fillon numërimin e votave dhe vijon me nxjerrjen e rezultatit përfundimtar të votimit.
2. Procesi i numërimit të fletëve të votimit dhe i nxjerrjes së rezultatit të votimit është i hapur.
3. Çdo fletë votimi i tregohet gjyqtarëve të pranishëm në mbledhje.
4. Komisioni i votimit vlerëson fillimisht votat e vlefshme dhe pastaj vijon me numërimin e tyre.
5. Votat që gjykohen paraprakisht si të pavlefshme rivlerësohen nga anëtarët e komisionit në fund të procesit të numërimit dhe votat që pas rivlerësimit gjykohen të vlefshme u shtohen kandidatëve përkatës.

KREU IV SHPALLJA E REZULTATIT

Neni 18

Shpallja e Rezultatit të Votimit

1. Komisioni i votimit, pas përfundimit të numërimit të votave, rendit kandidatët sipas votave që kanë marrë.
2. Në fund të procesit të votimit dhe të numërimit të votave mbahet një procesverbal, i cili tregon numrin e pjesëmarrësve, numrin e votave të hedhura, numrin e votave të pavlefshme në qoftë se ka, numrin e votave për çdo kandidat dhe emrat e kandidatëve të përzgjedhur. Rastet e mosmarrëveshjeve për vlefshmërinë e votave dhe mënyra e zgjidhjes së tyre shënohen në procesverbal. Në procesverbal shënohet edhe numri i fletëve të votimit që janë zëvendësuar për shkak të dëmtimit.
3. Në përfundim të procesit të votimit konsiderohet i zgjedhur për pozicionin e Kryetarit të Gjykatës së Lartë kandidati që ka shumicën absolute të votave të të gjithë anëtarëve të mbledhjes së përgjithshme.
4. Në rast se në votimin e parë asnjë nga kandidatët nuk arrin shumicën absolute të votave të të gjithë anëtarëve të mbledhjes së përgjithshme, organizohet menjëherë një raund i dytë votimi mes dy kandidatëve që kanë marrë numrin më të madh të votave. Nëse edhe në votimin e dytë asnjë nga kandidatët nuk merr numrin e nevojshëm të votave, kandidati me numrin më të madh të votave konsiderohet i zgjedhur si Kryetar i Gjykatës së Lartë. Në rastet e një barazimi votash, ka përparësi kandidati me përvojën profesionale më të gjatë si magjistrat në profilin gjyqtar.

Neni 19

Dokumentimi i Procesit të Votimit

1. Kancelari ose në mungesë të tij kryetari i komisionit të votimit, dokumenton të gjithë procesin e votimit dhe numërimit dhe harton listën e kandidatëve të renditur sipas numrit të votave të marra.
2. Rezultatet e votimit, në një listë me renditjen e kandidatëve, ruhen për tre (3) vjet.

Neni 20

Njoftimi i Vendimit

1. Vendimi i mbledhjes së përgjithshme për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë përmban rezultatin e votimit, emrin e gjyqtarit që është zgjedhur kryetar dhe ditën e fillimit të detyrës. Ky vendim nënshkruhet nga të gjithë gjyqtarët që kanë marrë pjesë në mbledhjen e përgjithshme dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Lartë.
2. Një kopje e vendimit i përcillet Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Neni 21

Dispozita Kalimtare

1. Deri në zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë, sipas nenit 51 të ligjit nr. 96/2016 “*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, të ndryshuar, ftesën për kandidatët që përmbushin kriteret ligjore për t’u zgjedhur kryetar, si dhe shpalljen e thirrjes për shprehjen e interesit e bën Zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë.

2. Procedura për shpalljen e thirrjes për shprehjen e interesit fillon brenda 1 (një) muaji nga hyrja në fuqi e këtyre rregullave.

3. Mbledhja e përgjithshme do të drejtohet nga Zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë dhe në pamundësi të tij nga gjyqtari me përvojën profesionale më të gjatë si gjyqtar në këtë gjykatë.

Neni 22

Hyrja në Fuqi

Këto rregulla hyn në fuqi në ditën e miratimit të tyre nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Gjykatës së Lartë.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

Aneksi nr. 1

K Ë R K E S Ë
PËR SHPREHJE INTERESI PËR POZICIONIN E KRYETARIT TË
GJYKATËS SË LARTË

Drejtuar: Mbledhjes së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë

Të nderuar pjesëmarrës,

Unë i nënshkruari _____, me detyrë, gjyqtar pranë Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 51, pika 9 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, paraqes kandidaturën time, për t’u zgjedhur në detyrën e Kryetarit të Gjykatës së Lartë.

Me konsideratë,

Gjyqtar i Gjykatës së Lartë

Sot më datë __. __. 202__

Aneksi nr. 2

GJYKATA E LARTË

FLETA E VOTIMIT PËR ZGJEDHJEN E KRYETARIT TË GJYKATËS SË LARTË

Nr.	Emër Mbiemër	Vota
1.		
2.		
3.		
4.		
5.		

GJYKATA E LARTË
FLETA E VOTIMIT KUR KANDIDATI PËR KRYETAR TË GJYKATËS SË LARTË
ËSHTË NJË GJYQTAR I VETËM

Nr.	Emër Mbiemër	Vota	
		Pro	Kundër
1.			

Shënim

Vota është e pavlefshme kur:

- a) fleta e votimit nuk ka të njëjtët elementë, sipas modelit të miratuar;
- b) në fletën e votimit janë bërë shënime në favor ose në disfavor të kandidatit/kandidatëve;
- c) është votuar për më shumë se një nga kandidatët;
- ç) nuk është votuar për asnjë nga kandidatët;
- d) nuk është e qartë se për cilin kandidat është votuar;
- dh) është votuar për një person që nuk është regjistruar si kandidat në fletën e votimit.